

Datë 28/10/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Let’s Go Circular/URBACT”, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I - “Shërbim i ekspertizës së jashtme - Përgatitja e Udhëzuesit/ Manualit për Eventet e Gjelbërta (Green Events)”, me fond limit 420,000 (katërqind e njëzet mijë) lekë pa tvsh.

Loti II - “Shërbim i ekspertizës së jashtme - Organizimi i Konferencës Përfundimtare të Projektit Let’s Go Circular”, me fond limit 314,889 (treqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 79341400-0, 79952000-2, 22470000-5

Vlera e fondit limit: 734,889 (shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Per lotin I - 30 ditë. Per lotin II - 1 (një) dite brenda muajt Dhjetor.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 10**;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1, si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” (i ndryshuar).

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 30% të fondit limit vlerës së përlogaritur të kontratës**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2, c) dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një **vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Loti I - “Shërbim i ekspertizës së jashtme - Përgatitja e Udhëzuesit/ Manualit për Eventet e Gjelbërta (Green Events)”

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre:

- 1 (një) Ekspert për hartimin e manualeve për organizimin e eventeve të gjelbra.

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim në: Inxhinieri Mjedisi/Shkenca natyrore/Menaxhim çdo profil tjetër ekuivalent që lidhet me fushën e shërbimit.)

- Përvoja profesionale: Mbi 5 vite përvojë pune në fushën e mjedisit, qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkulluese. Përvojë në hartim dokumentash lokale/kombëtare, si dhe njohuri mbi politikat e BE-së për evente të qëndrueshme.

Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e vlefshme
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Me certifikatë/ dëshmi profesionale ose diplomë.
-

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar). Pikën 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa specifike për stafin të kërkuar është përcaktuar në kuadër të termave të referencës që janë të nevojshme për të realizuar objektin e shërbimit nga ku përcaktohet qartazi dhe profili i stafit të nevojshëm që është kërkuar.

Eksperti do të ketë përgjegjësinë për hartimin e një manuali praktik, të plotë dhe të zbatueshëm për organizimin e eventeve të gjelbra në Tiranë në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe direktivat e BE-së. Do të përcaktojë standardet minimale për menaxhimin e eventeve me ndikim mjedisor të reduktuar. Do të kryejë konsultime me aktorët lokale.

Ky nivel përvoja dhe kualifikimi është i nevojshëm për të siguruar kapacitet të plotë profesional për hartimin e udhëzuesit të bazuar në praktika bashkëkohore të qëndrueshmërisë. Në këtë mënyrë garantohej që çdo parim mjedisor përputhet me politikat kombëtare dhe europiane. Gjithashtu, kjo përvojë është thelbësore për të siguruar integritetin në udhëzues të riciklimit, ripërdorimit dhe efikasitetin e burimeve.

Loti II - “Shërbim i ekspertizës së jashtme - Organizimi i Konferencës Përfundimtare të Projektit Let’s Go Circular”

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre:

- 1 (një) Koordinator i përgjithshëm i projektit
- 1 (një) Koordinator Teknik/Logjistik
- 1 (një) Fotograf Profesional/Videograf

Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e vlefshme

- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Me certifikatë/ dëshmi profesionale ose diplomë.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar). Pikën 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa specifike për stafin të kërkuar është përcaktuar në kuadër të termave te references që janë të nevojshme për të realizuar objektin e shërbimit nga ku përcaktohet qartazi dhe profili i stafit të nevojshëm që është kërkuar.

Numri i propozuar i anëtarëve të stafit (tre persona) konsiderohet i mjaftueshëm për të garantuar realizimin me cilësi të lartë të objektivave të përcaktuara në Termat e Referencës bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve si dhe neni 78, pika 2 i Vendimit nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

a) 1 (një) Koordinator i përgjithshëm i projektit

Koordinatori i përgjithshëm i projektit do të jetë përgjegjës për planifikimin, menaxhimin dhe ndjekjen e të gjitha aspekteve organizative dhe administrative të konferencës, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe objektivat e projektit.

Koordinatori do të udhëheqë ekipin për mbarëvajtjen e aktivitetit duke siguruar që shërbimet të kryhen në kohë. Është përgjegjës për mbajtjen e korrespondencës/komunikimeve me autoritetin kontraktor.

b) 1 (një) Koordinator Teknik/Logjistik

Koordinatori Teknik/Logjistik është përgjegjës për menaxhimin e pajisjeve teknike, logjistikën, prezantimet dhe mbështetjen teknologjike gjatë konferencës. Është përgjegjës për marrjen e masave për sigurimin e sallës ku do të zhvillohet aktiviteti; menaxhimi i regjistrimit të pjesëmarrësve; marrjen e masave për sigurimin e shërbimeve ushqimore (catering), marrjen e masave për sigurimin e materialeve shtesë dhe brandimin e materialeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Koordinatori Teknik/Logjistik siguron mirëfunksionimin e çdo pajisjeje teknike duke përfshirë laptop, monitor, foni etj. si dhe logjistikën mbështetëse për zhvillimin e aktivitetit. Bashkëpunon

ngushtë me Koordinatorin e Përgjithshëm të Projektit dhe pjesën tjetër të ekipit për të garantuar funksionimin e çdo aspekti teknik dhe logjistik.

c) 1 (një) Fotograf Profesional/Videograf

Fotografi Profesional/Videograf është përgjegjës për dokumentimin profesional të eventit duke përfshirë fotografi dhe video, nga momentet kryesore të aktivitetit.

Fotografi Profesional/Videograf duhet të ketë njohuri të mira dhe të përdorë pajisje bashkëkohore me teknologji të avancuar për të dokumentuar eventin, duke garantuar realizimin me standarte të larta të materialeve vizuale dhe përmbajtjes së prodhuar, në përputhje me kërkesat dhe qëllimet e Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë:

- Përvojë 3–5 vite në organizimin e eventeve profesionale në nivel kombëtar
- Eksperiencë në mbështetjen logjistike për konferenca me aktorë institucionalë dhe ndërkombëtarë (eksperienca të ngjashme).

Argumentimi: Kjo kërkesë për vitet e përvojës, nevojitet që të garantojë Autoritetin Kontraktor, se operatori ekonomik i cili do të marrë pjesë për organizimin e konferencës ka kapacitete të duhura dhe ofron siguri në marrjen pjesë për eventin. Këto kërkesa janë thelbësore për garantimin e cilësisë, efikasitetit dhe standardeve profesionale të aktivitetit që do të realizohet. Përvoja e mëparshme në organizimin e eventeve të ngjashme siguron që operatori të zotërojë njohuritë dhe kapacitetet e nevojshme për:

- planifikimin dhe koordinimin e elementeve logjistike dhe teknike të një konference
- menaxhimin e marrëdhënieve me aktorë institucionalë, partnerë ndërkombëtarë dhe pjesëmarrës të niveleve të ndryshme;
- garantimin e respektimit të afatave kohore dhe buxhetit të parashikuar;
- zbatimin e standardeve të protokollit dhe sigurisë në aktivitete të tilla

Kjo përvojë e dëshmuar është një tregues i aftësisë së operatorit për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të aktivitetit, me cilësi të lartë profesionale dhe në përputhje me kërkesat e institucionit porositës.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.
- Gjithashtu Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.
- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurat me 2 lote me objekt “**Let’s Go Circular/URBACT**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

SHËNIM: Në Termet e Referencës dhe Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, autoritetet/entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Let’s Go Circular/URBACT”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personat përgjegjës për prokurim.